



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI I POLICISË KRIMINALE

Nr. 3179/2 Prot.

Kopje Nr. 2
Tiranë, më 25.11.2021

Lënda: Dërgohet Vendimi i Gjykatës.

QËNDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

TIRANË

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 18839/1 prot, datë 15.11.2021, ju ridërgojmë për ekzekutim vendimin nr. 404 datë 25.10.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë. Sqarojmë se, vula e gjykatës ndodhet në faqen e parë të vendimit dhe më pas në krye të çdo flete në vazhdim. Mosekzekutimi i vendimit të gjykatës ju ngarkon me përgjegjësi ligjore.

Bashkëlidhur me këtë shkresë dërgojmë për ekzekutim Vendimin Nr.404, datë 25.10.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka vendosur, sekuestrimin e aksioneve të shoqërisë "ILIRIA ITALIAN TOUCH" sh.p.k me NUIS L87720503B, me adresë lagjia "Nënë Tereza" shëtitoria "Wilson", ZK. 3126, Shëngjin – Lezhë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI
Drejtues i Lartë Tonin VOCAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr. 404 akti
Datë 22.10.2021

Nr.404 Vendimi
Dt.25.10.2021 Vendimi

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

"Për ekzekutimin e Letërporosisë"

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup
gjykues të përbërë prej:

GJYQTARE: Atalanta ZEQIRAJ

Me pjesëmarrjen e sekretares gjyqësore **Evalda Jera**, në Tiranë, sot më datë 25.10.2021,
pasi mori në shqyrtimin në seancë gjyqësore, çështjen penale me Nr. 404 Akti, me palë:

KËRKUES: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar,
përfaqësuar nga prokurori **Ened Nakuçi**.

OBJEKTI: 1. Lejimin e ekzekutimit të letërporosisë nga jashtë shtetit të autoriteteve të Italisë, të
datës 15 Tetor të vitit 2021 sipas objektit të saj.

2. Për ekzekutimin e kërkesës për ndihmë juridike të ngarkohen oficerët e policisë gjyqësore në
Drejtorinë Hetimore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në zbatim të normave
proceduriale (neni 507.2 i K.Pr.Penale).

BAZA LIGJORE: Neni 15 i ligjit nr.10193, datë 03.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me
autoritet e huaja në çështjet penale" dhe neni 506 e vijues i K.Pr.Penale:

*Gjykata pasi shqyrtoi aktet shkresore të fashikullit të gjykimit dhe dëgjoji prokurorin
gjatë paraqitjes së tyre si dhe pasi vlerësoi kërkesën në harmoni me provat e administruara në
gjykim:*

VËREN SE:

I. Rrethanat e çështjes:



1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka paraqitur pranë kësaj Gjykate kërkesën penale me objekt: *1. Lejimin e ekzekutimit të letërporosisë nga jashtë shtetit të autoriteteve të Italisë, të datës 15 Tetor të vitit 2021 sipas objektit të saj. 2. Për ekzekutimin e kërkesës për ndihmë juridike të ngarkohen oficerët e policisë gjyqësore në Drejtorinë Hetimore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në zbatim të normave procedurale (neni 507.2 i K.Pr.Penale).*

2. Nga aktet e dosjes rezulton se, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor, me shkresën nr.863/1 prot/B.SH, datë 15.10.2021, me lëndë “Ndihmë juridike” i është drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke i bërë me dije se Ministria e Drejtësisë i ka dhënë rrugë kërkesës për ndihmë juridike datë 03.09.2021 të Prokurorisë së Republikës pranë Gjykatës së Rivogo-s Itali, në kuadër të procedimit penal për veprat penale “Organizatë kriminale me qëllim mashtrimi me TVSH” dhe “Pastrim i parave”, parashikuar nga legjislacioni Italian, me persona nën hetim Giuseppe la Rosa dhe të tjerë.

3. Nga aktet rezulton se, Prokuroria e Republikës pranë Gjykatës së Rovigo-s po vazhdon hetimet që kanë të bëjnë me krimin e organizatës kriminale me qëllim mashtrimi të TVSH e ashtuquajtur Karuseli dhe pastrim parash kundrejt 23 (njëzetë e tre) të hetuarve, ndër të cilët LA ROSA Giuseppe (lindur në San Cipriello (PA) më datë 01.07.1964 me rezidencë në Megliadino San Vitale, via Adige n.5).

Nga rezultati i hetimeve, Prokurori ka paraqitur te Gjyqtari i Hetimeve Paraprake kërkesën për sekuestro konservative të fitimit ndaj krimeve të parashikuara që u atribuohen personave nën hetim, midis të cilëve edhe për shtetasin LA ROSA Giuseppe. Gjyqtari Hetimeve Paraprake, në datë 25.06.2021 ka pranuar kërkesën duke lëshuar një dekret konfiskimi parandalues të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë përkatëse të fitimit kriminal të vlerësuar në Euro 3.823.049.00. Midis pasurive që rezultojnë në pronësi të LA ROSA Giuseppe figuron kompania me të drejta shqiptare ILIRIA ITALIAN TOUCH shpk, e konfirmuar nga komunikimi me institucionet përgjegjëse.

4. Nga të dhënat e përmendura për të zbatuar urdhërin e kërkuar nga Gjyqtari i Hetimeve Paraprake kërkohet që Autoritetet Gjyqësore Shqiptare të kryhen këto veprime:

- a) Për të vazhduar me sekuestrimin e aksioneve të shoqërisë së ILIRIA ITALIAN TOUCH sh.p.k, (NIPT -L87720503B) me adresë Lagjia “Nënë Tereza”, sheshi Wilson, zona

kadestrale 3126, Shëngjin, Lezhë (Albania), me objekt “restorant dhe aktivitetete të lidhura me restorantin”.

- b) Kërkoheq që të mos shpërndahet përmbajtja e kësaj kërkesë dhe mos të kryhen veprime të cilat mund t'i ndihmojnë personat në fjalë që të zbulojnë se po kryhen hetime kundrejt tyre.

Sa më sipër, Prokuroria e Posaçme mbështetur në Konventën Evropiane për ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjes Penale (ratifikuar me ligjin nr.9871 datë 11.02.2018), nenin 15 të ligjit nr.10193 datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” dhe në nenin 506 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, i ka kërkuar gjykatës lejimin e ekzekutimit të letërporosisë.

II. Ligji zbatueshëm:

- **Neni 505 i K.Pr.Penale parashikon** “1. Ministria e Drejtësisë vendos që t'i jepet rrugë letërporosisë së një autoriteti të huaj për komunikimet, njoftimet dhe për marrjen e provave, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesat të rëndësishme të shtetit. 2. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë edhe kur ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e procesit, si dhe kur nuk del që i pandehuri të ketë shprehur lirisht pëlqimin e tij për letërporosinë. 3. Në rastet kur letërporosia ka si objekt thirrjen e një dëshmitari, të një eksperti a të një të pandehuri para autoritetit gjyqësor të huaj, Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë letërporosisë kur shteti kërkuar nuk jep garancinë e duhur për paprekshmërinë e personit të thirrur. 4. Ministria ka të drejtë të mos i japë rrugë letërporosisë kur shteti kërkuar nuk jep garancinë e duhur të reciprocitetit”.
- **Neni 506 i K.Pr.Penale** “1. Letërporosia e huaj nuk mund të vihet në ekzekutim pa u marrë më parë vendimi në favor i gjykatës së vendit ku duhet të procedohet. 2. Prokurori i rrethit, pasi merr aktet nga Ministria e Drejtësisë, paraqet kërkesën në gjykatë brenda 5 ditëve nga paraqitja e akteve nga Ministria e Drejtësisë. 3. Gjykata disponon ekzekutimin e letërporosisë me vendim brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës. 4. Ekzekutimi i letërporosisë nuk pranohet: a) kur janë rastet që Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë letërporosisë, në përputhje edhe me parashikimet e akteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe rezervat e deklaramet ligjore; b) kur fakti

SHQIPËRI
SHKALLË
E ORGANIZIMIT
PARLAMENTAR

për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale”.

- Neni 507 i K.Pr.Penale parashikon “1. Gjykata që pranon kërkesën për ekzekutimin e letërporosisë, kryen dhe veprimin e kërkuar ose autorizon për këtë qëllim prokurorin, në rastet kur ligji e lejon. 2. Për kryerjen e veprimeve të kërkuara zbatohen normat e këtij Kodi, përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkuara nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar”.
- Neni 13 i ligjit nr.10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja në çështjet penale” parashikon: “1. Llojet e letërporosisë janë: a) njoftimi i aktit të thirrjes ndaj personit nën hetim, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit, të dënuarit apo palëve të tjera në procedimin penal; b) njoftimi i urdhrave, i vendimeve të autoriteteve gjyqësore dhe i dokumenteve të tjera të nevojshme që lidhen me procedimin penal në shtetin kërkues; c) masat e sigurimit pasuror për efekte të një procedimi penal; c) pyetja e personit nën hetim, të pandehurit, të dënuarit, dëshmitarit dhe ekspertit, qoftë edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me anë të lidhjeve telefonike dhe audiovizive; d) transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar, me qëllim pyetjen e tyre; dh) veprime të tjera hetimore, të cilat nuk janë të ndaluara nga ligji. 2. Krahas rasteve të procedimeve penale të parashikuara nga neni 3 i këtij ligji, ekzekutohen letërporositë e autoriteteve gjyqësore të huaja në procedimet administrative, nëse vendimi i dhënë në përfundim të tyre mund të ankimohet në një gjykatë me juridiksion penal. Ky rregull zbatohet deri në masën që parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë”.
- Neni 22 i ligjit parashikon “1. Me kërkesë të autoriteteve gjyqësore të huaja, autoriteti gjyqësor vendas mund të vendosë lejimin e kontrollit të vendeve ose sekuestrimin e sendeve të konfiskueshme që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në lidhje me faktet e përcaktuara në letërporosi. Vendimi mund të ankimohet brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale. 2. Autoriteti gjyqësor vendas kompetent kryen kontrollin dhe sekuestrimin në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Penale. 3. Kur një palë e tretë, që ka fituar të drejta në mirëbesim, një autoritet shtetëror apo një palë e dëmtuar, që ka vendbanimin ose vendqëndrim në Shqipëri, pretendon pronësinë mbi sendet, dokumentet apo fitimet, sendet

e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dërgohen vetëm nëse autoriteti gjyqësor i huaj garanton kthimin e tyre në fund të procedimeve në lidhje me provat. 4. Dërgimi mund të shtyhet për aq kohë sa sendet, dokumentet apo fitimet janë të nevojshme për procedimet penale të filluara në Shqipëri.

III. Vlerësimi i Gjykatës:

➤ Lidhur me kërkesën për ekzekutimin e letërporosisë.

5. Gjykata çmon se çdo shtet brenda kufijve të tij merr vetë masat që i gjykon më të nevojshme për të ndjekur krimet dhe për të ndëshkuar kriminelët në bazë të ligjeve të tij. Mirëpo shpesh herë, për të luftuar me sukses kriminalitetin, është e nevojshme edhe ndihma e shteteve të tjera.¹ Gjykata vlerëson se, ndihma e ndërsjellë juridike në fushën penale është një nga format më të rëndësishme të bashkëpunimit me autoritete e huaja. Kjo formë përfaqëson ndihmën që një shtet i jep shtetit shqiptar dhe anasjelltas, në çështjet për të cilat ka filluar procedimi në shtetin kërkues dhe që ndjekja penale dhe dënimi janë nën juridiksionin e atij shteti. Në nenin 10 të K.Pr.Penale, nën titullin “**Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare**”, parashikohet shprehimisht se: “1. Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij Kodi”. Format e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale janë katër: ekstradimi, ndihma e ndërsjellë, transferimi i procedimi dhe ekzekutimi i vendimeve penale të huaja.

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen me Ligjin Nr. 10 193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritete e huaja në çështjet penale”, ku në nenin 13 të këtij ligji nën titullin “**Llojet e letërporosive dhe fusha e zbatimit**”, parashikohet se: “1. Llojet e letërporosive janë: a) njoftimi i aktit të thirrjes ndaj personit nën hetim, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit, të dënuarit apo palëve të tjera në procedimin penal; b) njoftimi i urdhrave, i vendimeve të autoriteteve gjyqësore dhe i dokumenteve të tjera të nevojshme që lidhen me procedimin penal në shtetin kërkues; c) **masat e sigurimit pasuror për efekte të një procedimi penal**; 5 ç) pyetja e personit nën hetim, të pandehurit, të dënuarit, dëshmitarit dhe ekspertit, qoftë edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me anë të lidhjeve telefonike dhe audiovizive; d) transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar, me qëllim pyetjen e tyre; dh) veprime të tjera hetimore, të cilat nuk janë të ndaluara nga ligji.”, ndërsa në nenin 14

¹ Shiko vendimin Nr. 665, datë 17.12.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

të këtij ligji nën titullin “**Veprimet për ekzekutimin e letërporosive**”, parashikohet se: “1. *Ministria e Drejtësisë, pas dhënies rrugë, ia përcjell aktet prokurorit të rrethit ku duhet të ekzekutohet letërporosia, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga marrja e akteve. Në raste urgjente, Ministria e Drejtësisë mund t’ia përcjellë aktet prokurorit të rrethit, duke njoftuar njëkohësisht Prokurorin e Përgjithshëm.* 2. *Prokurori i rrethit paraqet kërkesën në gjykatë për të disponuar ekzekutimin e letërporosisë me vendim, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale. Ky rregull nuk zbatohet kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.”.*

6. Më tej, letërporosia nga jashtë shtetit rregullohet nga K.Pr.Penale. Në nenin 505 të këtij Kodi parashikohet shprehimisht se: “1. *Ministria e Drejtësisë vendos që t’i jepet rrugë letërporosisë së një autoriteti të huaj për komunikimet, njoftimet dhe për marrjen e provave, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesa të rëndësishme të shtetit.* 2. *Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë edhe kur ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e procesit, si dhe kur nuk del që i pandehuri të ketë shprehur lirisht pëlqimin e tij për letërporosinë.”.* ndërsa në nenin 506 të K.Pr.Penale nën titullin “**Procedimi gjyqësor**”, parashikohet se: “1. *Letërporosia e huaj nuk mund të vihet në ekzekutim pa u marrë më parë vendimi në favor i gjykatës së vendit ku duhet të procedohet.* 2. *Prokurori i rrethit, pasi merr aktet nga Ministria e Drejtësisë, paraqet kërkesën në gjykatë.* 3. *Gjykata disponon ekzekutimin e letërporosisë me vendim.* 4. *Ekzekutimi i letërporosisë nuk pranohet: a) kur janë rastet që Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë letërporosisë; b) kur fakti për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale”.* Gjithashtu, në nenin 507 të K.Pr.Penale nën titullin “**Ekzekutimi i letërporosive**”, parashikohet shprehimisht se: “1. *Në vendimin e ekzekutimit të letërporosisë caktohet trupi gjykues që do të kryejë veprimin e kërkuar.* 2. *Për kryerjen e veprimeve të kërkuara zbatohen normat e këtij Kodi, përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkuara nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar.”.*

7. Duke u kthyer në çështjen konkrete, Gjykata çmon se, plotësohen kushtet e parashikuara nga kuadri ligjor i përmendur më lartë, për t’u pranuar kërkesa për ekzekutimin e letërporosisë të

REPUBLIKA E SHqipërisë
-E POSAÇME-
autoriteteve italiane të drejtësisë, përkatësisht për të vazhduar sekuestrimin e aksioneve të shoqërisë së ILIRIA ITALIAN TOUCH sh.p.k (NIPT-L87720503B), me adresë: lagjja "Nënë Tereza", sheshi Wilson, zk 3126. Shëngjin, Lezhë (Albania), me objekt "restorant dhe aktiviteteve të lidhura me restorantin". **Së pari**, kërkesa e autoriteteve të drejtësisë italiane i plotëson kushtet formale, si a) autoritetin nga i cili ka ardhur kërkesa, b) objektin dhe motivin e kërkesës, c) Nga ana e autoritetit janë përshkruar rrethanat e faktit, të dhënat lidhur me personin në hetim dhe shoqërinë ILIRIA ITALIAN TOUCH sh.p.k; **Së dyti**, në rastin konkret nuk ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e hetimit e gjykimit pranë autoriteteve të drejtësisë së italisë. **Së treti**, fakti penal i cili i atribuohet shtetasit të huaj parashikohet nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë si vepër penale.

8. Në ekzekutimin e kësaj letërporosie, Gjykata çmon se duhet mbajtur në konsideratë neni 13 i K.Pr.Penale, nën titullin "**Gjykatat penale të shkallës së parë dhe përbërja e tyre**", ku thuhet se: "1. *Veprat penale gjykohen në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore, gjykatat për krime të rënda dhe Gjykata e Lartë, sipas rregullave dhe përgjegjësisë të caktuara në këtë Kod.* 2. *Në gjykatat e shkallës së parë gjykohen nga një gjyqtar: ...c) kërkesat për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.*", dhe neni 507 i K.Pr.Penale nën titullin "**Ekzekutimi i letërporosive**", ku thuhet shprehimisht se: "1. *Në vendimin e ekzekutimit të letërporosisë caktohet trupi gjykues që do të kryejë veprimin e kërkuar.* 2. **Për kryerjen e veprimeve të kërkuara zbatohen normat e këtij Kodi, përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkuara nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar**". Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, kërkesat për ekzekutimin e letërporosive gjykohen nga një gjyqtar dhe ekzekutimi i tyre bëhet në përputhje me K.Pr.Penale të Republikës së Shqipërisë.

9. Sa më sipër, kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme duhet pranuar, pasi është në përputhje me nenin 16 të Ligjit Nr. 10 193, datë 03.12.2009 "**Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritete e huaja në çështjet penale**".

Gjykata vlerëson se, duke qenë se ekzekutimi i letërporosisë lidhet me sekuestrimin e aksioneve të shoqërisë ILIRIA ITALIAN TOUCH sh.p.k, duhet të procedohet edhe me administrimin e pasurive nga Agjencisa për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në Ministrinë e Financave, Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:


Gjykata, bazuar në nenet 13, 505, 506 dhe 507 të K.Pr.Penale, nenin 18 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj, ratifikuar me Ligjin Nr. 8920, datë 11.07.2002 dhe të Ligjit Nr. 10193 datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet Juridiksionale me autoritetet e Huaja në çështjet penale”.

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Lejimin e ekzekutimit të Letërporosisë së autoriteteve italiane të drejtësisë, përkatësisht të Gjyqtarit të Hetimeve Paraprake, duke vijuar me seksuestrimin e aksioneve të shoqërisë ILIRIA ITALIAN TOUCH sh.p.k me nipt L87720503B, me adresë: lagjja “Nënë Tereza”, sheshi Wilson, zk 3126, Shëngjin-Lezhë-Albania, me objekt “*restorant dhe aktiviteteve të lidhura me restorantit*”.
3. Për ekzekutimin e kësaj Letërporosie ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë Hetimore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
4. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të njoftoj nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, autoritetet e drejtësisë italiane për ekzekutimin e kësaj letërporosie.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 (dhjetë) ditëve² në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.10.2021!

GJYQTARE
Atalanta ZEQIRAJ



² Neni 22 pika 1 i ligjit nr.10193 parashikon “1. Me kërkesë të autoriteteve gjyqësore të huaja, autoriteti gjyqësor vendas mund të vendosë lejimin e kontrollit të vendeve ose sequestrimin e sendeve të konfiskueshme që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në lidhje me faktet e përcaktuara në letërporosi. Vendimi mund të ankimohet brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale”.